

Shkëlqesia Juaj, President i Republikës së Shqipërisë, Prof. Bajram Begaj

E nderuara znj. Armanda Begaj

E nderuara znj. Nagavci, Ministre e Arsimit Shkences dhe Teknologjise

I nderuari ztr. Mala, Ambasador I Republikes se Shqiperise

I nderuari ztr. Alban Hyseni, Kryetar I Komunes se Gjilanit,

Te nderuar zvMinistra, Gashi dhe Ademi,

Shume te nderuar Rektor Hoxha, prof Marku, Rektor Krasnqi, rekto Kosumi

I nderuar Kryesues I Kuvendit Komunal z. Kadriu , Familja Zeka, ish te burgosur politike,, Deputete, Drejtore , perfaqesues te Mediave

Të nderuar anëtarë të komunitetit akademik,

Të dashur studentë, qytetarë të Gjilanit, miq dhe të ftuar të tjere te nderuar,

Sot, në këtë ceremoni solemne në Universitetin “Kadri Zeka” të Gjilanit kemi nderin e veçantë që t’i ndajmë titullin “Doctor Honoris Causa Shkëlqesisë së Tij, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Prof. Asc Bajram Begaj. Ky nuk është vetëm një titull formal, por një shenjë e thelle falënderimi, respekti dhe mirënjohjeje për një jetë në shërbim të kombit të dijes dhe të humanizmit.

I nderuar President Begaj,

Rruga juaj jetësore është një shembull i rrallë përkushtimi profesionalizmi dhe urtësie. Nga qyteti i Rrogozhinës, në auditorët e Fakultetit të Mjekësisë në Tiranë, e më tej në strukturat më të larta te Forcave të Armatosura të Shqipërisë, ju keni treguar se dijet dhe

ndërgjegjja mund të ecin krah për krah në shërbim të njerëzimit dhe të kombit.

Ju nuk ishit thjesht një profesionist i shquar i mjekësisë. Ju ishit dhe mbeteni një udhëheqës që bart uniformën me ndërgjegje dhe përkushtim. Si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe si President i Republikës, ju keni qenë zëri i qetë, por i vendosur, kombit tonë.

Në momentet më të errëta të historisë sonë, kur Kosova kishte nevojë për dorën e vëllait, ju ishit aty. Jo për lavdi, por për përkushtim. Jo për pozicion, por për mision. Edhe sikur të gjithë të harrojnë, populli Kosovës JU kujton. Qytetarët e thjeshtë të Gjilanit ju kujtojnë. Ata që ecen zbatuar drejt kufirit, ata që kërkuan strehë, ata që përjetuan dhimbjen ata ju falënderojnë, sepse ju ishit aty me zemrën tuaj.

Por angazhimi juaj nuk përfundoi me luftën. Në kohë paqeje, ju ishit po aq të pranishëm – përkrahës i pavarësisë sonë, mbrojtës i të drejtave tona, përkrahës i arsimimit dhe i zhvillimit institucional. Ju i dhate Kosovës vend në fjalorin diplomatik të Shqipërisë, dhe forcë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

I nderuar president,

Në Kosovë ju jeni ne vendin tuaj.

Në Gjilan, ju jeni ne shtëpinë tuaj.

Te qytetarët tanë, ju jeni ne mes vëllezërve tuaj, të cilëve ju u dolët ne ndihmë në kohët më të vështira.

Dhe në Universitetin që mban emrin e heroit kombëtar Kadri Zeka, gjen një tempull të dijes, respektit dhe kujtesës sonë historike.

Sot, përmes këtij titulli, ne ndajmë një vlerësim që shkon përtej akademisë. Ne nderojmë një njeri që mishëron virtytet më të larta të një udhëheqësi modern: njeri të dijes, të karakterit dhe të përgjegjësisë.

Le të jetë ky akt, një mesazh për të gjithë studentët tanë:

Po, ia vlen të studiosh.

Po, ia vlen të shërbesh.

Po, ia vlen të jesh i ndershëm, i përkushtuar dhe njerëzor.

Ju, President Begaj, jeni simbol i asaj që duhet të përfaqësojë elita e kombit: një njeri që ndërton ura, që mbjell besim, që udhëheq me maturi dhe shembull.

Në emër të Universitetit “Kadri Zeka”, të Senatit tonë Akademik dhe të gjithë qytetarëve të këtij vendi që nuk harron, sot kam nderin t’ju dorëzoj titullin:

“Doctor Honoris Causa” i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.

Urime nga zemra, Shkëlqesi.